




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.



Nr. 445 Regj., Nr. 2308/1 Prot.

Tiranë, më 16/09/2022

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

Për dijëni: Debitorit, Subjekti "AGROCON ALBANIA" sh.p.k. me NIPT: L324060240
Adresa: Fshati Ngurrës e Vogël, Rruga "Qëndër", Krutje, Lushnje,

Kreditorit, Shoqëria "Bruka Seedling" sh.p.k.
Adresa: Me seli, Divjakë

Objekti: Pagesë Fature Tatimore Shitje

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k. me numër NIPT: L62204027C, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.34, datë 23.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.445 kërkesën e kreditorit, Shoqëria "Bruka Seedling" sh.p.k. ndaj subjektit "AGROCON ALBANIA" sh.p.k. në lidhje me Titullin Ekzekutiv Akti Administrativ "Faturë Tatimore Shitje" Nr.59, datë 25.09.2019.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2275/2 Prot, datë 15.07.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit,

KONSTATOVA se :

Debitori, "AGROCON ALBANIA" sh.p.k. është vënë më dijëni për njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit, subjektit "AGROCON ALBANIA" sh.p.k. në masën, që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe 53 të Ligjit Nr.26/2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

URDHËROJ

Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:

Debitori, Subjekti "AGROCON ALBANIA" sh.p.k. me NIPT: L324060240

Adresa: Fshati Ngurrës e Vogël, Rruga "Qëndër", Krutje, Lushnje

1. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:
 - a) Adresën e ushtrimit të aktivitetit.
 - b) Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence.
 - c) Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K

Përmbarues GJYQËSOR


Egerem SPAHIU

